



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), dispozitave të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010, për bashkëpunim ndërkomunal, nenit 5 të Rregullores nr. 09/2013, për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal, dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

V E N D I M
PËR NISMËN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL

I.

MIRATOHET Vendimi për nismën e Kryetarit të Komunës së Prishtinës për bashkëpunim ndërkomunal.

II.

Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet në mes të Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Lipjanit, në lidhje me ndërtimin e rrugës Slivovë-Peshter.

III.

Autorizohet Kryetari i Komunës për të filluar konsultimet me komunat si në pikën II të këtij vendimi, për përgatitjen e propozimmarrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-024/01-112379/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

